



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL V/2022

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 5 (pestë) për vitin 2022 të Kuvendit të
Komunës së Suharekës**

**Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 30.05.2022
Ora: 10.00**

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z. Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyqi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj. Doruntina

Zenelaj

Z. Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj. Sanie Kuçi

Rexhepaj

Znj. Mimoza

Bajrakatari

Znj. Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Znj. Saranda

Bajraktari

Z. Driton Maliqaj

Z. Xhevxhet Gashi

Z. Edon Sadikaj

Z. Dardan Berisha

Z. Bajram Basha

Znj. Mevlude Kabashi

Znj. Sheqerije Zyrapi

Znj. Laureta Tafaj

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Znj. Festë Kabashi

Z. Herolind Limaj

Znj. Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

**Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj. Habibe Bytyqi
Z. Xheladin Sadikaj**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi.

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve „Emblema e artë“ dhe mirënjohjen „13 Qershori“ ;**
- 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për bonus banimin;**
- 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit „Ballkani“ ;**
- 5. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit.Kemi një kërkesë nga grupi i LDK-së.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit.Në emër të grupit të LDK-së propozojë që të futet në rend dite edhe një pikë e re:Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirimin nga taksat në aktivitet për të gjitha bizneset që operojnë në territoron e Komunës së Suharekës.Duke marrë për bazë që një numër i madh i komunave tashmë e kanë larguar këtë taksë dhe duke parë përshkallëzimin e krizës ekonomike kohën e fundit dhe vështirësitë që kanë bizneset në ushtrimin e aktiviteteve të tyre, e me theks bizneset e vogla dhe të mesme,mendojmë që sado pak përmes këtij projekt-vendimi t'ia lehtësojmë aktivitetin e tyre dhe ti japim mbështetje.Kërkojmë që secili prej jush,pa dallim partie ta aprovoni që të hyjë në rend dite, e pastaj të debatohet dhe të vendosim bashkarisht.

Kryesuesi - sa për informim kjo pikë ka qenë dhe në KPF,është diskutu dhe nuk ka kalu.LDK po kërkon të futet dhe një pikë shtesë në rend dite, e cila kërkon që të zgjatet afati i debatit publik për Harta Zonale.

Selman Kolgeci - përshëndet të pranishmit.Kemi takuar shumë qytetarë të cilët për arsye të mos arritjes së informacionit të ta,nuk kanë arritur të marrin pjesë në takimin qendror për Harta Zonale Komunale.Me qëllim që të njoftohen sa më shumë qytetarë,grupe të interesit,profesionist,unë në seancën kur është vendos për diskutim publik HZK, pata propozuar që të ndahen në zona me nga një tubim të përbashkët në tre-katër fshatra.Por ju një gjë të tillë nuk e keni përkrahur.Mendoj që duhet përkrahur nisma për zgjatjen e afatit të diskutimit publik për shkak se u jep mundësi qytetarëve të paraqesin komentet apo ankesat eventuale për pronat e tyre.Nëse komentet,vërejtjet dhe ankesat do të përfshihen në HZK, që është obligim ligjor,do të kemi më të lehtë implementimin e Planifikimit Hapsinor.

Në bazë të udhëzimit administrativ 05/2014 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor për përgjegjësit e autoriteteve të planifikimit hapsinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesmarrje publike në planifikim neni 8 i këtij udhëzimi,njoftimi publik dhe kohëzgjatja e shqyrtimeve publike pika 3 thotë:shqyrtimi publik për projekt-dokumentet e planifikimit hapsinor zgjat së paku 30 ditë.Pra, nuk do të thotë të jetë fiks 30 ditë por mund të jetë më gjatë se kaq, por jo më pak se kaq.Ftoj kolegët asamblesit që së bashku,ti ofrojmë mundësi më shumë qytetarëve që s'kan qenë në dijeni për afatin e shqyrtimit publik dhe të bëhet zgjatja prej së paku 15 ditë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e parë shtesë-Lirimi nga taksat në aktivitet.

15 për, 15 kundër, 1 apstenim

Pasi votat janë të barabarta,Kryesuesi e shfrytëzon të drejtën e votës së dyfishtë dhe pika e parë shtesë për lirimin nga taksat në aktivitet nuk kalon.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e dytë shtesë, për shtyerjen për 15 ditë të shqyrtimit publik për Harta Zonale.

17 për,13 kundër,1 apstenim
Miratohet në rend dite

Kryesuesi - hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

30 për,1 apstenim
Miratohet rendi i ditës

Pika1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - nuk ka vërejtje në procesverbal, Kryesuesi e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve „Emblema e artë“ dhe mirënjohjen „13 Qershori“ ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - a do të votohen si pako apo do ti ndani si çmime çmime?

Kryesuesi - si pako.

Bulëza Kuçi - atëherë, ne si grup parlamentar i LDK-së e apstenojmë këtë proces,me arsyetimin sepse e mendojmë si vendim politik,pa informacione paraprake,mungesë e dokumentacionit në komision,p.sh. Rregulloren për ndarje.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit.Me të dal thirrja për propozime me date 27 prill 2022,ne si grup i PDK-së kemi marrë obligim që ti njoftojmë permes rrjeteve sociale të gjithë qytetarët,shoqatat e dala nga lufta,kryetarët e nëndegëve,kryesinë e partisë që të japin propozimet e tyre për këto shpërblime.Të gjitha këto figura të cilat janë të propozura,kanë bërë shumë për këtë vend. Në bazë të epitetit të festës, plotësisht i besojmë anëtarit të komisionit që e kemi pas dhe jemi pro këtij vendimi.

Festë Kabashi - përshëndet të pranishmit.Unë pajtohem me reagimin e Bulëzës sepse jemi të dyja anëtare në komisionin në fjalë.Vlerën dhe kontributin e ish luftëtarëve të UÇK-së nuk duhet ti kontestojmë por duhet ti japim meritat e duhura në çfarëdo lloj forme që kemi mundësi.Sa i përket mbledhjes së këtij komisioni,ne anëtarët nuk kemi qenë të paisur paraprakisht me materialet e domosdoshme,as me CV-të e aplikuesve.Poashtu rregullorja përkatëse nuk ka qenë në dokument fizik,ka mungu.Personat të cilët sipas vendimit të komisionit do të marrin mirënjohjet,propozoj që të votohen një nga një dhe jo si pako,sepse ka pas propozime për të cilët unë kam apstenu ose kam votu kundër dhe në këtë rast logjikisht nuk mundem të votoj pro tyre dhe ta ndryshoj vendimin dhe qëndrimin tim.

Kryetari - përshëndet të pranishmit.Ne në muajin shkurt kemi pas takim me shoqatat e dala nga lufta,kanë marrë pjesë prej të gjitha fshatrave.Është bo shpallja publike.Është komisioni i cili ka vendos dhe për mua mund të votoni ose një nga një ose pako,por këta njerëz e kanë dhënë një kontribut dhe disa janë postmortum.Vendosni vet.

Driton Maliqaj - përshëndet të pranishmit, Mendoj që nuk duhet me nxjerr në votim si pako ose veq e veq,për shkak se thirrja ka qenë për 13 Qershorin. Ne duhet ta qesim në votim si pako me thirrjen 13 Qershorit për këto shpërblime.

Kryesuesi - e hedh në votim që votimi me shku në pako.

18 vota për

Kryesuesi - u mor vendim që votimi të bëhet në pako,pasi u votua me shumicë të votave për.

Qëndrim Elshani - për sa i përket numrave po shihet që i keni. Por kisha kërku nga opozita që me votu propozimin tone, që ta japim edhe ne mendimin se për kë kishim votu për e për kë kundër.

Dardan Berisha - në momentin që e shoh që një kryesi e OVL-së që e ka dhanë një propozim për një kandidat, realisht dhe moralisht nuk duhet as me diskutu. Nëse kthehemi në të kaluarën, unë ju bëj pyetje atyre në anën e majtë, a e dini kush ka marrë këso shpërblime? Unë e di kush ka marrë këso shpërblime, d.m.th Kryetarët e nëndegëve të partive.

Urim Suka - jep sqarime. Nëse e keni kuptu Bulëzën, Bulëza e ka kontestu procesin, Ju po e devijoni si po doni.

Kryetari - po befasohem me grupin e asambleistëve se çfarë mendimi kanë për njerëzit që kanë ra për këtë vend.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e dytë si pako me këto propozime: Shpërblimi “Emblema e artë” ti ndahet Bislim Zyrapit nga fshati Studenqan, ndërsa Mirënjohja “13 Qershori” i ndahet Avdullah Melit Morina nga fshati Samadraxhë (postmortum), Enver M. Zeqaj nga fshati Samadraxhë (postmortum), Shefki Muqa nga Suhareka (postmortum), Afrim D. Sylaj nga fshati Sllapuzhan dhe Qazim N. Musaj nga fshati Samadraxhë.

18 për, 12 apstenime
Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për bonus banimin;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - në KPF e kam bërë një pyetje por nuk jam kan i qartë. Për këtë pikë ndoshta ka qenë mire me pas një raport se cilat kanë qenë ato 7 familje përfituese të viti të kaluar, dhe për sa vite zgjat. A ka mundësi që prap e njejtat familjet duhet me apliku për të njejtën banesë, dhe a kemi mundësi që ne si asamble ta formojmë një komision, sepse nuk e dim kush është në komision dhe kush e bën ndarjen e bonus banimit.

Besa Kuçi - përshëndet të pranishmit. Vendimi i Asamblesë për bonus banim është hera e tretë që del në Asamble. Është caktu nga Asambleja që do jenë 7 familje, 40 % me 60 %. Ekziston një komision, bëhet shpallje publike. Është komisioni prej tre personave që është formu prej Drejtorisë së Shëndetësisë. Drejtoresha e shëndetësisë tutje vazhdon sqarimet.

Kryesuesi - ishte dhe pyetja se a duhet prap ato familjet me konkuru.

Besa Kuçi - pasi vendimi është për një vit duhet të riaplikojnë.

Urim Suka - sa i përket këtij projekt-vendimi ne e kemi trajtu dhe e kemi mbështet dhe në KPF, dhe prap e mbështesim. Ne kërkojmë që këto mjete të shkojnë në vendin e duhur. Do ta përcjellim se si do të shkoj ky proces dhe në qoftëse do të vërejmë parregullsi do ti adresojmë. Mendoj që brenda mundësive me qenë numri i familjeve edhe ma i madh do të ishte edhe ma i mirëseardhur.

Laureta Tafaj - përshëndet të pranishmit. Nëse vitin e kaluar kanë qenë 7 familje që kanë marrë bonus banesën, dhe këtë vit janë prap të njejtat, që besoj prap e marrin, A nuk mujna me bo ma shumë banesa për tjerë, pra me shtu numrin e banesave.

Besa Kuçi - nga të dhënat e publikuara nuk janë të njejtat 7 familje, pasi shumë që kanë përfitu bonus banim e kanë zgjidh problemin e banimit dhe janë tërheq nga bonus banimi. Sa i përket për me rrit numrin, do të ishte mire nëse mundësitë buxhetore na lejojnë. Por këtë vit nuk na lejojnë pasi i paguajmë prej kategorisë së subvencioneve dhe e kemi buxhetin e limitum.

Mevludë Kabashi - përshëndetje për të gjithë. A kish qenë ma mire me zgjat kohëzgjatjen e bonus banimit. Me bo 3 ose 5 vjet që mos me qenë shumë e mundimshme për familjet që për çdo vit me apliku.

Avni Bytyqi - vendimin për bonus banim, ligji e thotë që çdo vit duhet Kuvendi ta miraton paraprakisht vlerën dhe shumën për të cilën përcakton Komuna apo Kuvendi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. „Shqyrtimi i projekt - vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit „Ballkani“ ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Laureta Tafaj - përshëndet të pranishmit. E përgëzoj dhe i uroj suksese klubit të Ballkanit. Desha mi pyt kolegët nga KPF-ja se si mund të sillni në Kuvend një kërkesë e cila sipas rregullores së vitit 2013 neni 4 nuk i ka të kompletuara këto dokumentacione, si: certifikatën e regjistrimit, arsyetimin e kërkesës me prova të qarta dhe bindëse, numrin e llogarisë bankare të personit juridik jo fitimprurës, informatën vjetore mbi aktivitetin dhe qarkullimin financiar. Si mund të votoni një pike të tillë ku fillimisht keni pranuar projekt-vendimin e më pas kërkesën? Duke u thirrur përsëri në rregulloren e viti 2013 për subvencion neni 6 pika 4 thotë: nëse ndihma financiare është më e madhe se 5 mijë euro, për të njëjtën vendos Komisioni për Politikë dhe Financa me pëlqim paraprak mbi delegimin e kësaj kompetence dhe Kuvendit i paraqitet raport për çdo 6 muaj, gjë që ju nuk e keni bo. Kolegë të dashur, ju lutem, mendone dhe një here. Si do të dilni para qytetarëve tu thoni që jeni zëri i tyre në kuvend kur me vetëdije të plotë po i shpenzoni paratë e tyre në një firmë private në këtë kohë krize ekonomike. Mos bini pre e premtimeve të kota të disa personave ku ju thuhet se: unë e dërgoj kërkesën në Kuvend, nëse kalon i ndajmë paret bashkë, nëse jo, Kuvendi del keq se nuk ju ka mbështet. Nëse Drejtoria e Kulturës ka mjaftueshëm fonde dhe nuk po din ku me i shpenzu, atëherë kemi mjaftueshëm klube, siq është Ylli e shumë të tjera që na përfaqësojnë denjësisht.

Urim Suka - ne sot nuk do duhej të bënim debatin se a duhet mbështetur FC Ballkanin apo jo. Ne sot kemi një realitet të ri dhe ky realitet është që ekipi jonë FC Ballkani ka shkruar histori. Ky rezultat është meritë e pamohueshme e shumë gjeneratave që kontribuan ndër vite, është rezultat i angazhimit të secilit lojtar e pjesëtar të FC Ballkanit gjatë gjithë historisë së tij, e padysh është rezultat i investimeve të shumta që janë bërë ndër vite e sidomos vitet e fundit. Dhe natyrisht që duhet të jemi falemderues e mirënjohës ndaj secilit donator të FC Ballkanit e veqanërisht investitorëve të viteve të fundit. Ajo që ne duhet të themi sot, është qasja e Komunës në raport me sportin në përgjithësi. Ne sot para vetes kemi një vendim për mbështetjen e FC Ballkanit për të cilin do të duhej të binim dakord të gjithë, që duhet mbështesim. Por qasja e këtij pushteti është tepër jo serioze. Pothuaj se në secilin takim të kuvendit vin projekt-vendime të papërgaditura, të paanalizuara, të keqplanifikuara dhe na vënë në pozitë të vështirë për vendimmarrjen tone. Tani kur flasim për qasjen e Komunës karshi sportit Therandas, lindin disa pyetje që kërkojnë përgjigje. 1. Cila është mbështetja që komuna ofron për klubet e sportistët tjerë që zhvillojnë garat në nivel kombëtar e ndërkombëtar? 2. Cila do të jetë mbështetja, nëse edhe ndonjëri nga këto klube shpallet kampion apo arrin rezultate të larta kombëtare e ndërkombëtare? 3. Cila është mbështetja e Komunës për sportet që janë më pak popullore e që edhe më pak mbështeten nga bizneset? 4. Cila është mbështetja që komuna ofron për kategoritë e reja që zhvillojnë aktivitete e tyre në kuadër të klubeve të ndryshme e që janë e ardhmja e sportit Therandas? Këto dojnë përgjigje dhe dëshmojnë se Komuna jonë ka një qasje të papërgjegjshme, diskriminuese karshi sportit. Lidhur me këtë ne propozojmë që: fillimisht të rritet fondi për sportin, të ndalet diskriminimi në ndarjen e fondeve për klubet sportive, fondet të ndahen në mënyrë proporcionale, fondet të kenë karakter stimulimi për rritjen e suksesit, të kemi fonde të veqanta për grupmoshat, të parashihen investime në poligone investive edhe nëpër vise rurale. Kërkoj nga ky pushtet që ta tërheq këtë projekt-vendim dhe në procedure të përsheptuar të përgatit një projekt-vendim tjetër gjithëpërfshirës, jodiskriminues dhe në harmoni me rezultatet edhe nga klubet tjera. Për kundër dëshirës për ta mbështetur FC Ballkanin, ne detyrohemi të mos e mbështesim këtë projekt-vendim.

Selman Kolgeci - i uroj qytetarët dhe FC Ballkanin për titullin. Sa i përket pikes, i jeni referuar ligjit për qeverisje lokale L Nr.03/L-040 D neni 17 lidhur me nenin 40, në fakt ky nen e trajton zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standarteve për kontrollimin e ndërtimit. Mendoj që duhet të vlerësohet ky lëshim dhe të përmirësohet, pra nuk ka të bëjë fare me subvencione apo përkrahje tjera të sportit. Nëse mbledhim shumën e aktiviteteve, del se vlera është 81 mijë euro dhe jo 80 mijë siq është kërkuar. Do të donim të denim se çka do të ndodh me klubet tjera sportive? Pse nuk po i përkrahni të gjitha klubet e qytetit? Kryetar, KF Samadraxha është tërhekur nga gara për 1000 euro. E mbështes propozimin e

Urimet. Propozoj që këtij projekt-vendimi ti bashkangjitet edhe mbështetja për klubet tjera, si Yllit, klubi i volejbollit "Theranda" e të tjerave.

Kryetari - ne nuk kemi bo shkelje. Kemi pas auditimin dhe nuk ka shkelje. Të gjitha klubet do të stimulohen, janë edhe 120 mijë euro tjera subvencione. Do të shkojmë në bazë të fuqisë që e kanë.

Urim Suka - kjo tendenca për mi tjetërsu fjalët çka thu është e tmerrshme. E para, në KPF të njejtat fjalë që i thash këtu gati i kam thane. Dallimi ka qenë që unë e kam përcjell për me ardh këtu dhe nuk e kom votu që me mbështet si projekt-vendim. Jo 80 mijë, por 200 mijë bane projekt-vendimin dhe unë ka me ta votu. Por jo veq Ballkanin, se dje e kemi duartrokkit Yllin, dhe nesër bohet Ylli kampion. Bëne një projekt-vendim gjithëpëfshirës që nuk i diskriminon klubet, nuk e diskriminon sportin dhe në proporcion me rezultatet dhe sukseset, edhe 200 mijë ia japim Ballkanit.

Dardan Berisha - fillimisht dhe ligjërisht besoj që kemi të drejtë. Klubi i Ballkanit 2013-2017 e ka marrë tepozën, për shkak të mungesës vetëm pse e ka drejtu klubin dikush tjetër. 86 mijë euro nuk është dasht vitin e kalum me ja dhan. Në PDK-ja nuk e kemi kalu sepse kemi qenë në pandemi dhe ka pas kriza tjera. Fillimisht është arrit marrëveshja ndërmjet komunës dhe kompanisë Cima construction për klubin e futbollit Ballkani, dhe ajo që më shqetëson mu, është që komuna në asnjë formë nuk ka qasje në klub. Për hir të performances dhe asaj që gjendet klubi i Ballkanit, ne do ta përkrahim.

Alban Berisha - përshëndet të pranishmit. Pa dasht me fy askënd, unë mendoj që dej sa të hym në seance na mujna me ni vetin tifoz, por këtu duhet me hek petkun e tifozit, duhet mu bo njerëz publik dhe për çka jemi të zgjedhur. Dardan, po lidhesh në vitin 2013-2017, dhe po thu që u kanë ni kryetar tjetër që politika se ka dash. Por edhe atëherë politika ka past gisht kur u bo Kryetar me qat mandat të atij Kryetari, dhe ka pas përkrahje. Për votën e vitit të kalun që the, unë me disa koleg kemi votu pro sepse u kanë pandemia, klubi ka pas kriza, ka met pa as një titull, pa asnjë vend dhe i kemi dhënë përkrahje. Edhe pse, arsyeja edhe vitin e kalum edhe sivjet nuk më ka pëlqy asnjëherë. Jemi në një situatë të keqe se shumica jemi dashamirë të futbollit. Me votu po, dikush ka me na thane i keni votu mi qu në Turqi, me votu kundër, jeni kundër Ballkanit.

Dardan Berisha - nuk dashta me personalizizimi këtë debat. Në vitin 2013-2017 nuk ke qenë asambleist dhe është mire mu inform prej kolegëve që kanë qenë, se si ka rrjedh procesi dhe si ka ardh klubi deri në performance negative. Vitin e kalum su kan dasht me votu për shkak të pandemisë, e jo tash. Mos e mbro veten. Për hir të performancës dhe për hir të asaj që po shkojmë në Europë, e vetmja arsye është kjo.

Alban Berisha - krijohet një presedent shumë i keq nëse ne kqyrim mi subvencionu veq ata që bohen kampiona. Pikërisht duhet mi përkrah ata që s'bohen, për mu bo në t'ardhmen kampiona. Duhet ti përkrahim por jo me pretendimin që po bohen kampion.

Dardan Berisha - e din asambleistët e legjislaturës 2013-2017 pse u ndërpre bashkëpunimi ndërmjet klubit. U ndërpre bashkëpunimi vetëm pse e ka drejtu dikush tjetër.

Aziz Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Urime klubit të Ballkanit. Unë nuk jam najfar tifoz dhe nuk e shoh si tifoz, por është evidente se të gjithë jemi krenar për sukseset e klubit të Ballkanit. Duhet ta mbështesim jo vetëm që është bërë kampio, por unë Ballkanin e shoh dhe me një sens tjetër. Është një klub i organizuar mirë i cili funksionon në gjitha nivelet dhe është në shërbim të qytetarëve. Shumë të rinjë tanë angazhohen në Ballkan prej moshave të reja dhe merren me sport. Kjo tregon se shumë të rinjë tanë largohen nga fenomenet negative. Çdo klub që ka sukses dhe që është në shuarje duhet ta ndihmojmë. Ju ftoj ta përkrahni.

Sanie Kuqi Rexhepaj - sa i përket pikes së rendit të ditës se sa është krenar secili prej neve, është e padiskutueshme dhe nuk besoj që është temë e diskutimit për sot. Mirëpo temë e diskutimit sot është mundësia buxhetore që ka Komuna për me i financu të gjitha klubet dhe sportistët në mënyrë proporcionale. Viti 2022 mendoj që nga vlera financiare ekonomike veq po shkon duke u rëndu më shumë. Jemi në një situatë ku vlerat e Kovidit që janë nda për qytetarët ende nuk janë të paguara. Jam dakord me Albanin ku tha që klubet nuk duhet mi ndihmu vetëm kur shpallen kampion, mirëpo ma shumë duhet mi ndihmu paraprakisht klubet apo sportistët të cilët kanë ambicie me mri ma lart. Ne veq e kemi ndihmu klubin e Ballkanit vitin e kaluar, kështu që jam dakord që klubet që shpallen kampion me i shpërbly, mirëpo jo në vlerë kaq të lartë, duke marrë parasysh buxhetin që ka Komuna. Në KPF qëndrimi im ka qenë kundër që me ardh në Asamble dhe vazhdon të jetë akoma.

Mevlude Kabashi - iniciativa për me ndihmu klubin futbollistik Ballkani është për tu vlerësuar,por mendoj që nuk është prioritet këtë vit, sepse Ballkani me pjesmarrjen në ligën e kampionëve i ka të garantuara 400 mijë euro.Poashtu ai një shumë të caktuar e ka marrë edhe nga Federata e Futbollit të Kosovës.Përveq kësaj Ballkani ka edhe të hyra vetanake të cilat i siguron nga futbollistët e rinjë,të cilët paguajnë 30 euro në muaj.Nëse klubi futbollistik Ballkani i merr 80 mijë euro,a kish pas mundësi të rinjëve me ja lehtësu shumë 30 euro?Nëse kish qen pro,unë atëherë jam pro këtij projekt-vendimi.

Kushtrim Kuçi - iu kemi gëzu faktit që Ballkani ka mrri me u bo kampion i Kosovës,Shpresojmë që lojën e ardhshme edhe Ylli të bëhet kampion.Unë sa për koiqidencë,përball banesës ku unë jetoj, javën e kalume i bona këto foto. - Tregon fotot dhe thotë që klubi i shigjetarisë ushtron në katin e dytë të ndërtesës në kushte shumë të këqija.Është mire ti ndihmojmë këtij ekipi me një 5 mijë eurosh.Unë ju garantoj që edhe këtu ka me pas talenta,por jo 80 mijë euro vetëm një ekipi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

17 për, 11 kundër,2 apstenime Miratohet pika 4

Pika shtesë

Kryesuesi - anëtari i LDK-së Selman Kolgeci kërkon që të shtyhet afati e debateve publike për Hartat Zonale.

Kryetari - edhe unë jam pro,jo 15 ditë por një muaj.Vetëm shikone a kemi të drejtë në aspektin ligjor.

Visar Kuçi - për pikën që tha Selmani,ne tash veq jemi vonë,sepse shqyrtimi publik prej 30 ditësh ka përfundu.Harta Zonale është projekt i veqantë, i cili i ka ndjek të gjitha procedurat.Harta Zonale e ka udhëzimin administrative të veqant,është udhëzimi administrative 24 2015.Në rast kur nuk kemi kërkesa,mund të shtyhet afati,por kemi pas 135 kërkesa dhe 350qytetarë i kemi pas në zyret tona.Ju në Asamblenë e kalune e keni votu një komision që është kthy prap dhe unë kam frikë që ju e votoni për me shty por ministria e kthen prapë.

Selman Kolgeci - unë nuk thashë që nuk i keni ndjek procedurat,por unë u thirra në udhëzimin administrative 05 2014 të Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor për shqyrtime publike.Keni pas ankesa dhe ka akoma.Çka ka të keqe me zgjat edhe 15 ditë afatin për diskutim publik.Ju e dini që nëse ato ankesa janë të bazume dhe nuk lejojnë me kry një objekt ose një rrugë ose qka keni parapa në pronat e tyre,ju nuk muni me ekzekutu Hartën Zonale.Kërkoj edhe 15 ditë me shty,ti marrim ende ankesa,vërejtje e komente.

Visar Kuçi - të premtën kanë qenë vetëm 6 ose 8 kërkesa.Tash kanë me dal bujqit dhe kanë me apliku për leje për shtalla,kanë me kërku subvencione,dhe pa u aprovu Hartat Zonale nuk muj me lëshu leje.

Selman Kolgeci - sa i përket bujqëve,kjo qeveri lokale ka kallzu në seancën e kalune,ku ja ka hek gjys milioni bujqëve.Sa i përket ankesave unë të shtunën në zyrën time private i kam prit 15 palë që skan mujt mi parashtru ankesat e tyre.

Visar Kuçi - pse s'na ki bo ni kërkesë gjatë shqyrtimit 30 ditësh me shty afatin.

Selman Kolgeci - ka shumë njerëz që nuk e din kur përfundon kjo.

Visar Kuçi - Hartat Zonale është një prej proceseve ma transparente në komunë të Suharekës.

Selman Kolgeci - obligimin ligjor e keni kry,por kërkohet edhe 15 ditë.

Visar Kuçi - nëse ekipi i ekspertave dhe ekipi komunal e paresh që duhet mu shty sepse nuk kemi pas kërkesa të mjaftueshme,atëherë na e shtym ose ministria e kthen në rishqyrtim edhe 15 ditë të tjera.

Sanie Kuqi Rexhepaj - votova kundër kësaj pike,sepse mendoj që nuk është kompetencë e Kuvendit,por është kompetencë komplet e ekipit komunal dhe e këshillit të ekspertave për me e caktu sa ditë ka mu mbjat shqyrtimi publik,ku me udhëzim caktohet minimalja 30 ditë. Mendoj që është e paarsyeshme si Kuvend me marrë një vendim të tillë duke marrë parasysh që Drejtoria e Urbanizmit duhet me prit edhe 15 ditë ligjshmerinë plus 15 ditë të tjera shqyrtimin publik dhe plus sa zgjat faza e shqyrtimit të ankesave.Le t'ja lëmë në dorë këshillit të ekspertave dhe ekipit komunal për planifikim,meqenëse ia kemi besu punën dej tash dhe le ta qojnë deri në fund.

Avni Bytyqi - sa i përket qështjes së afatit së shtyerjes së shqyrtimit publik, neni 8 i udhëzimit administrative thotë: 8 ditë para hapjes së shqyrtimit publik duhet të njoftohen qytetarët dhe shqyrtimi publik nuk guxon të jetë më i shkurt se 15 ditë dhe jo më i gjatë se 30 ditë. Dhe në këtë rast drejtoria për Urbanizëm është kompetent dhe ka për obligim që nëse konstaton dhe vlerëson që ka nevojë të shtyhet afati,paraprakisht duhet ta njoftojë Ministrinë Planifikimit Hapsinor dhe të merr paraprakisht pëlqimin nga ministria nëse vërtetë ka kërkesa dhe ankesa shumë. Zyrтари ligjor tutje vazhdon me sqarime.

Selman Kolgeci - arsyetim bindës mendoj që është shqetësimi i qytetarëve.Ne kërkojmë vetëm 15 ditë me shty diskutimin publik.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**12 për,16 kundër,
Nuk kalon pika shitesë**

Pika 5. Pyetje dhe përgjigje;

Selman Kolgeci - pyetje për Kryetarin dhe Drejtorin Visar Kuçi. Në seancën e kaluar kemi diskutuar rreth qështjes së informimit të qytetarëve se qyteti është duke u monitoruar nga kamerat e sigurisë. Poashtu kemi marrë premtim publik nga ju z.Muharremaj se kjo qështje do të ketë kujdesin institucional dhe për atë jeni deklaruar se do të paisen me sinjalistikë të gjitha hyrjet e qytetit.Informim ky i cili do të ndalonte së shkeluri privatësinë personale të qytetarëve.Deri në momentin që po flasim, ju nuk e keni relizuar këtë premtim e që është obligim ligjor.Kërkoj që ky problem të rregullohet dhe njëkohësisht duam ta dijmë se a mund të marrim një zotim tjetër nga ana juaj se kur saktësisht do të bëhet ky intervenim.Pyetje për Drejtoreshën Besa Kuçi:së paku dy seancat e kaluar kemi diskutuar për problemin e furnizimit me oksigjen në QKMF dhe AMF.Kam kërkuar t'na trgoni se çfarë oksigjeni u keni dhënë qytetarëve tanë,oksigjen industrial apo oksigjen medicinal,dhe deri më sot nuk kemi marrë përgjigje.Dua ta dime se a i keni pare edhe ju këto rezultate të testimeve të oksigjenit që ju kanë konfiskuar nga inspektoriat i linjes në bazë të urdhërave të prokurorisë.Nëse e keni rezultatin a mund ta publikoni para Asamblesë.Kujtojmë që ju keni deklaruar, madje shumë shpejt që do ta firmosni marrëveshjen për furnizim me gaz medicinal për QKMF dhe AMF-në.A keni me i furnizu institucionet tona me gaz medicinal? Para disa ditësh kemi pa që keni filluar vizitat për gratë shtatëzana dhe fëmijët e sapolindur.Normal, e përkrahi si projekt.Por a jeni të vetëdijshëm që gjatë një postimi i keni shkelur privatësinë pacientëve duke i publikuar fotografitë gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti.A do të vazhdoni ta shkelni privatësinë e pacientëve edhe në të ardhmen apo kjo vërejtje do të shërbejë që ju të vetëdijesoni dhe ti mbronni të drejtat dhe privatësitë e pacientit.Pyetje për Drejtorin e Arsimit: Në seancën e kaluar kemi diskutuar për shpenzimet që kjo drejtori i ka bërë në shpenzime gjyqësore dhe kemi kërkuar raport të detajuar se sa shpenzime kanë shkuar për mësimdhësimdhënës,sa shpenzime gjyqësore e sa në tarifa të përmbaruesve privat.Besoj i keni pëgatit dhe kërkoj t'na i prezantoni.Pyetje për Kryetarin Muharremaj: Z.Muharremaj para disa ditësh kemi pa që një qytetarë i joni,i Eko Regjionit,gjatë kryerjes së punëve është lënduar,siq ishte thënë, nga shpërthimi i një bombole Për të njejtin person ju keni nda mirënjohje. Nuk e di çka keni dasht të bëni me atë mirënjohje përpos popullizmit.Por një qytetrë i joni,i fshatit Vraniq ka rënë dhe është lënduar në një pusët të hapur rreth tri metra,e cila është raportu edhe nëpër media se kjo pusët paraqet rrezik.A do ti ndani mirënjohje vetës dhe zotit Shabani për funksionimin e kurtheve të tilla apo jo?

Kryetari - atij djali qysh i ka ndodh,ishalla nuk i ndodh kërkuajna dhe besoj kërkuajna nuk u kan i kënaqur. Punëtorët e Eko Regjionit janë punëtorët që kanë dhanë më së së shumti.Atij djali iu ka nda një shpërblim për ti dal ato ndihmë financiare. Keni drejt me na kritiku por duhet me na kuptu dhe ju e dini që para dy jave e kemi marrë buxhetin dhe pa zotim dhe pa alokim të mjeteve nuk kemi pas mundësi me vazhdu procedura.

Besa Kuçi - sa i përket procesit për furnizim me gaz medicinal,QKMF ende nuk ka një raport prej inspektoriatit farmaceutik,dhe në momentin që e kemi, keni me pa edhe ju. Ne kemi bo kërkesë në zyrën e prokurimit për furnizim me gaz medicinal dhe e kemi nënshkru një kontratë me kompaninë e licencume

dhe jemi furnizu me gaz.Sa i përket vizitave për nanat shtatëzana dhe fëmijë,ky shqetësim i yti është me vend,por ne kemi lejen e prindit për publikimin e fotografive dhe kemi dëshmi.

Selman Kolgeci - në fund është dasht me shenu që fotografia është publiku me lejen e prindit.

Remzi Bajselmani - sa i përket shujtave edhe ne jemi të shqetësuar për këtë punë,dhe çdo takim me ministrinë diskutohet kjo punë.Ka Komuna të cilat kanë nda buxhet prej mallra dhe shërbimeve për me realizu,mirëpo është thënë në mënyrë decitive që kjo punë nuk mund të kryhet nga Komuna.Deri tani janë shpenzu mjete buxhetore por komuna jonë nuk është prek ende sepse mjetet janë nal nga fondi paga dhe medetje,që është marrë drejtpërdrejtë prej fondit të ministrisë.Nga listat që kanë ardhë ne nuk i kemi të gjitha,sepse disa shkojnë në dorë të avokatëve,disa te permbaruesve e disa kryhen me një procedure ma të shkurtër drejtpërdrejt në gjykatë.Një listë e fundit që ka ardh është një shumë reth 220 mijë euro,ku 113 mijë euro kanë shku për pjesë e shpenzimeve ndërsa përfituesit janë 107 mijë euro.

Selman Kolgeci - kërkojmë ti dim saktë këto shpoenzime që po bohen.

Urim Suka - kam këkesë me të cilën i drejtohem Kuvendit apo dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike.Këto ditë kam marrë shqetësime nga bizneset e qytetarë lidhur me lokacionin për deponi të ngurtë në Shirokë,përkatësisht në fund të Zonës Industriale.Sipas tyre kjo deponi nuk është në vendin e duhur dhe është kthyer në pengesë të mallrave për biznese e qytetarë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre apo jetojnë afër kësaj deponie.Me qëllim që këto shqetësime të adresohen kërkoj që Drejtoria e Shërbimeve Publike ta jep një konkluzion ose të formohet një komision i Kuvendit i cili mundet me na rekomandu qysh me bo zgjidhjen e kësaj.Në Bllacë tash e sa kohë kanë problem me ndriçimin publik,ka plot rrugë që nuk janë të përfshira në ndriçim,por problemi qëndron edhe te mosfeksionimi i ndriçimit publik ku rreth mbi 30 % e rrjetit ekzistues nuk funksionon.Vitin që lam pas,Komuna ka pas një kontratë për sanimin e dëmeve,që ka mujt mi sanu.Kur do të funksionalizohet rrjeti ekzistues që është jasht funksionit dhe a pritët që të kemi shtrirje të rrjetit në ndriçim publik edhe në rrugët e reja në fshatin Bllacë për këtë vit.

Kryetari - plotësisht ke të drejtë.Në shumë fshatra shkojnë i nalin.Tash fillojumë me ndriçim dhe kemi me shtu sasinë e ndriçimit,në çdo fshat ku kemi mundësi.Në shumë fshatra shkojnë dhe i nalin siguresat në mbrëmje.

Urim Suka - problemi i ndiçimit publik në Bllacë nuk është i javëve të fundit dhe e dyta ti po thu skena pas mjete.Vitin e kalum e ke pas buxhetin e ndan për mirëmbajtje dhe sanim dhe si ke nreq.

Enver Shabani - jemi model për komunat në Kosovë për deponinë e mbeturinave inerte.Është e vërtetë që kohë pas kohe krijohet një lloj tollovie,por sido qoftë po menaxhohet.Sipas parashikimeve tona dhe të kompanisë që menaxhon këtë deponi,maksimalisht edhe një vit do të mbusht ajo deponi dhe siq është e paraparë në një kontratë, ajo deponi do të shëndrrohet në një oaz të gjelbër.

Urim Suka - unë nuk e di gjendjen detalisht të deponisë,por unë paraqita shqetësimet e qytetarëve dhe i besoj atyre.

Kryetari - ne kur ta marrim hapin tjetër,kemi me marrë së bashku me juve,por prap ku ta qojmë një deponi kemi me pas problem.

Dardan Berisha - kam dy kërkesa dhe kërkesa e parë shkon përmes DKA-së te Kryetari dhe asociacioni i Komunave.Sipas mundësive të ngritet qështja e uljes së kriterit për plotësimin e normave për formimin e paraleleve nëpër shkolla.Kërkesa tjetër është për Drejtorinë e Arsimit : Mundësisht si të vje mundësia e parë me iu liru mjete librarive,sepse kanë ankesa për furnizim sepse s'po kanë mjete.

Festë Kabashi - kam pyetje për Drejtorinë e Arsimit.E di që Ministria e Arsimit është përgjegjëse për shpërndarjen e librave,por kam pas rast personalisht por edhe në diskutim me disa kolege që punojnë në shkolla tjera,në disa prej tyre ka mungesë të teksteve shkollore ndërsa në disa ka tepricë.A do të thotë kjo që është një keqmenaxhim i drjetorisë në fjalë apo ndoshta informacionet nuk janë të sakta prej drejtorit të shkollave.

Remzi Bajselmani - Sa i përket teksteve,Ministria e Arsimit është përgjegjëse për ndarjen.Të dhënat i dërgojnë DKA-të.Formohet një komision për ndarjen e tyre në bashkëpunim me libraritë.Drejtorët e shkollave i bin të dhënat dhe bëhet ndarja e librave.Kompanitë e kanë për obligim mi dërgu librat në shkollat përkatëse. Kemi komunikim me libraritë ,vërtetë janë vonu pagesat për shkak që është vonu buxheti.Janë në proces pagesat për të gjitha faturat që kanë ardhë në DKA.

Kryetari - besoj që në komunën tonë nuk ka mbet askush pa punë.Edhe që kanë shku ngrëzit në penzion,jemi mundu ato orë mi shpërnda.Ky problem nuk është vetëm në Komunën tonë.Në takim me Ministren,ajo ka thënë që do ta bëjmë të mundurën që mos me lan kërkënd jasht viti shkollor.

Laureta Tafaj - pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike :Është mandati i dytë që kërkoj me u sanu rruga « Zenel Curraj » në Grejkoc dhe « 28 Nëntori ».Asnjëherë nuk më ke përkrah,por është interes i gjithë banorëve.Nëse fjala ime nuk qon peshë,atëherë tregom kush duhet me ardh me të thanë ty që ato rrugë me u rregullu.

Enver Shabani - jep përgjigje.

Kryetari - në momentin e parë që e merr Kompania për sanimin e rrugëve në Suharekë,do të kryhen rrugët që kanë bo kërkesë asambleistët.

Kushtrim Kuçi - përmende ndriçimin në Shirokë.Mos të shkojmë në Shirokë.Është sheshi që e ka bo Blerim Kuçi,këso projekte kapitale dhe ndriçim mos me pas lveq mos u arsyeto që skeni poqa me ble.A i mbikqyrni ato punime që i boni ?

Alban Berisha - Pyetje për Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike :a është e nevojshme dhe a u analizu najher që mu vendos kamerat në klasë.Sepse duke qenë prind,shumë shpesh nëpër takime me mësues dhe arsimtarë,ka pas ankesa që po ndodhin dame brenda klasës.Kam vërejt që ndëshkohet e gjithë klasa.A është shkelje e privatësisë nëse vendosen kamerat dhe sa ka produktivitet nëse vendosen. Kamerat në qytet ,sa e di janë të vendosuna prej Kuvendit komunal dhe të gjitha shpenzimet i bart Kuvendi komunal,kurse menaxhohen prej policisë.Kërkoj nga Kryetari që si Kryesues i KKSB-së me kërku një raport,se sa i kanë shërby kamerat stacionit të policisë së Kosovës.

Kryesuesi - sa e di, 7 kompani të autobusave janë denu.

Kryetari - janë të vendosura deri në Shirokë dhe me të vërtetë iu kanë hy në punë.Ka raste të aksidenteve që janë zbulu përmes kamerave.Avniu e ka obligim që seancën e parë që kem me KKSB-në me kërku një raport se sa iu kanë hy në punë kamerat prej vendosjes së parë që janë vendos.Ne do ta bim edhe një vendim tjetër në Asamble dhe do të kërkojmë shtesë punën e kamerave për rrugën që shkon për Mushtishet,rrugën që shkon për Budakovë,rrugën për Rahovec.Unë do të dal me vendim dhe do ti njoftojë qytetarët.Tash kemi me bo largimin e deponive ilegale dhe të gjitha do të postohen përmes televizioneve, sepse është e pamundshme të largohen deponitë në Komunën e Suharekës.

Remzi Bajselmani -.Të gjitha shkollat janë të paisura me kamera dhe i vëzhgojnë pikat kyqe,ku kanë konstatu drejtorët e shkollave,ndërsa vendosja e kamerave në klasa është e ndalune me ligj.

Urim Suka - me i emnu drejtorat për 6 muaj është marre.Ndërrone qasjen se i man n'sandazh.

Kryetari - fillojnë dëgjimet publike nëpër fshatra dhe është mirë çdo asambleist me marrë pjesë dhe mi pa kërkesat e qytetarëve.

Visar Kuçi - ne e kemi bo porosinë e tabelave informuese dhe besoj deri në Asamblenë tjetër kanë mu kan të montune.

Selman Kolgeci - shpresoj që kanë me u kry,por nëse se kryn kompania,posedona që donacion ka me ja bo Suharekës.

Takimi përfundoi : 12 :10

Procesmbajtësja :
Dafina Haziraj